



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202201157/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda:** *Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientet e Komisarariatit të Policisë në Mat.*

**Drejtuar:** Drejtues i parë Dhimitraq ZIU  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër

**PESHKOPI**

Z. Ervin HASRAMA  
Shef i Komisarariatit të Policisë në Mat

**BURREL**

**Për dijëni:** Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisariatin e Policisë Mat.

Inspektimi u krye në datën 23.09.2022, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Hazbi Selita me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimin dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin

e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas që iu është privuar liria, grupi i punës u takua me Zv/shefin e Komisarariatit të Policisë në Mat, z. Lorenc Alia i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, Zv/shefi i Komisarariatit raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, gjegjësisht në lidhje me masat e marra për përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisarati.

Nga informacioni i drejtuesve të komisarariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm<sup>1</sup>, rezultoi se:

- **Ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e një regjistri të veçantë për të miturit të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar në konflikt me ligjin ku të evidentohen të gjitha rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente.
- **Ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të kamerave në këtë Komisarariat, për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe hyrjeve të dhomave të sigurisë.

---

<sup>1</sup> Rekomandimi dërguar me shkresën nr. K4/I40-2 Prot., datë 15.11.2021.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në Komisariatin e Policisë në Mat, si dhe ndërtimin e ambienteve të reja sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde *“Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e ambientit ekzistues të sigurisë, kryesisht në plotësimin e dhomave të sigurisë me krevat për fjetje, eliminimin e lagështirës dhe zgjerimin e dritareve për hyrjen e ajrit dhe ndriçimit të plotë natyral.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit në Komisariatin e Policisë në Mat, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e menjëhershme të masave për plotësimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë pasi mungesa e tyre ndikon ndjeshëm në mbarëvajtjen e punës në këtë institucion.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të kamerave në këtë Komisariat, për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të dhomave të shoqërimit.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës (zyrës) të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar të rritur dhe të mitur në këtë komisariat, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të ngrohjes në ambientin e sigurisë dhe atë të shoqërimit, për shkak të kushteve të renduara atmosferike të kësaj zone.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e vizitës inspektuese, vijoi takimin me punonjës të informacionit dhe përgjegjës të dhomave të sigurisë në Komisarariat të Policisë në Mat, inspektoi kushtet e mjedisit të shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të cilët kryenin veprime procedurale hetimore me personat e shoqëruar, si dhe u njoh e administroi dokumentacionin ku ishin evidentuar të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, gjatë kohës së qëndrimit në mjediset e këtij komisarati.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjës të policisë të Komisarariatit të Policisë Mat me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit, si dhe inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në përfundim të inspektimit, pavarësisht disa masave që ishin marrë për respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, në Komisarariat të Policisë Mat vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika thelbësore si më poshtë:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisarariat të Policisë Mat, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>2</sup>

Grupi i inspektimit konstatoi se ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës të komisarariatit dhe përbëhej nga 1(një) dhomë, për personat e rritur. Për personat e shoqëruar të mitur, sipas informacionit, mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë në prani të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe psikologut.

Dhoma e shoqërimit ishte në tërësi me hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme. Dritarja e dhomës ishte me përmasa të tilla që lejonin hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale. Ajo ishte e lyer por lagështira ishte e dukshme. Por, **nuk ishte e pajisur** me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige/stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 3/d e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Në këtë ambient, ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i përbashkët dhe jo i ndarë më vete për meshkuj dhe femra.<sup>4</sup> Kushtet higjieno-sanitare të tij nuk ishin të mira. Dera e dhomës së shoqërimit mbyllej me çelës, me bravë të rregullt.

Në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

Për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar të rritur, femra dhe të mitur, përdroreshin zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat ndodheshin në katin e dytë të godinës.

Në mjediset e komisariatit nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në dhomat e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje apo pajisje të tjera elektrike, për sigurimin e ngrohjes të ambientit kryesisht në periudhën e dimrit.

Në kohën e inspektimit, kishte një person të shoqëruar në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati. Ndërsa për periudhën Janar - Shtator 2022 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 124 persona të shoqëruar në mjediset e këtij komisariati.

### **Ambientet e sigurisë, kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Në Komisaratin e Policisë në Mat ambienti i sigurisë **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

Ambienti i sigurisë ndodhej në një godinë më vete, ngjitur me godinën kryesore të këtij komisariati. Ky ambient kishte në total 12 dhoma sigurie, nga të cilat ishin në përdorim vetëm 5(pesë) prej tyre, të ndara në 3(tre) dhoma për akomodimin e personave të rritur meshkuj, 1(një) për femra dhe 1(një) për të mitur. Ndërsa dhomat e tjera ishin të mbyllura dhe të vulosura, për shkak se ishin nxjerrë jashtë funksionit.

Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për akomodimin e 10 (dhjetë) personave të arrestuar/ndaluar.

---

<sup>4</sup> Kreu VI, pika 3/e e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Dhomat e sigurisë **nuk** plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të ndaluar/arrestuar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 m<sup>2</sup> dhe e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>.<sup>5</sup> Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe nuk mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale.

Dhomat kishin ndriçim elektrik e furnizoheshin nga rrjeti elektrik. Por, komisarati kishte dhe gjenerator si burim rezervë energjie, për të vënë në përdorim pajisjet elektrike dhe ndriçuar ambientin. Në dhomat e sigurisë **nuk** kishte shtretër dhe personat e ndaluar/arrestuar flinin në dyshekë që vendoseshin mbi dyshtemenë prej dërrase.

**Ambienti i sigurisë vazhdonte të kishte shumë lagështirë dhe ishte i amortizuar në tërësi. Qëndrimi i shtetasve të arrestuar/ndaluar në këto kushte përbën trajtim degradues, ndaj Institucioni i Avokatit të Popullit përsërit rekomandimin për mbylljen sa më parë të këtyre ambienteve dhe krijimin e një ambienti sigurie sipas standardeve të përcaktuara në kriteret për ndërtimin e tyre.**

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje dhe pastrim vetjak në tualetet, që ndodheshin në korridorin e ambientit të sigurisë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm i cili nuk ishte funksional.

Në ambientin e sigurisë nuk kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për dimër apo pajisje të tjera për ngrohje, sikurse parashikohet në procedurën standarde<sup>6</sup>. Mungesa e këtyre elementëve për ngrohje, ndikon në jetën dhe shëndetin e personave të arrestuar/ndaluar për kohën e qëndrimit në këto ambiente. Mungesa e ngrohjes dhe lagështira përbëjnë rrezik.

Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Sikurse, brenda në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile, për njoftimin e punonjësve të shërbimit nga ana e personave të arrestuar/ndaluar në rast nevojë.

Brenda në ambientin e sigurisë kishte një dhomë për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Kjo dhomë nuk

---

<sup>5</sup> *Kreu VIII, pika 3.3 e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*.

<sup>6</sup> *Kreu VIII, pika 3.2/c e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*

përmbushte standardet, pasi ishte e pandriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e kamerave për 24 orë.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të arrestuar/ndaluar në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Mat.

Nuk kishte ambiente për të dalë në ajrim duke bërë që këto kushte nuk ofrojnë trajtim dnjitoz të personave që kalojnë midis 48 orë në 4-5 ditë në këto ambiente.

Nga informacioni i zv/shefit të komisarariatit rezultoi se, ende dhe këtë vit nuk është bërë i mundur sigurimi i fondeve financiare nga buxheti i shtetit, për realizimin e ndërtimit të ambienteve të reja të dhomave të shoqërimit dhe sigurisë, sipas të gjitha parametrave dhe kërkesave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore.

Megjithatë u njohëm me dokumentin me nr. 2659 prot., datë 31.08.2022 me titull “*Detyrë-Projektimi Rikonstruksion/ Ndërtim i objekteve të Komisarariatit të Policisë Mat*” i miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, i cili ka bërë një studim mbi nevojën e ndërhyrjeve me qëllimin e plotësimit të nevojave dhe përmirësimin e standardeve të akomodimit, për të krijuar infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive ligjore të institucionit.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”<sup>7</sup> dhe “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”<sup>8</sup>, parashikohet se çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

---

<sup>7</sup> *Kreu VII, pika 5, parashikuar në Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

<sup>8</sup> *Kreu XI, pika 1, parashikuar në Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

Nga verifikimi, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Koha e arrestimit apo ndalimit të të shoqëruarve ishte e njëjtë me kohën e shoqërimit të tyre pranë organit të policisë.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarariat evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë, grupi i inspektimit u njoh dhe administroi kopje të regjistrave të tjerë që evidentonin gjithë aktivitetin 24 orësh, që zhvillohej me personat e arrestuar/ndaluar, të cilët ishin plotësuar sipas rubrikave dhe ishin të sekretuar.

Nga verifikimi i regjistrave ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisarariatit të policisë, konstatoam se, zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës të viteve të kaluar lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra në orën kur personit është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës.

Ndërkohë, në zbatim të kërkesave të nenit 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, komisarati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Për periudhën Janar - Shtator 2022 nuk ishin evidentuar kërkesa/ankesa nga ana e personave të arrestuar/ndaluar.



## **Ambientet e intervistimit**

Në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë në Mat kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët, e cila nuk ishte e monitoruar me sistemin e kamerave.

Gjithashtu, marrja në pyetje/intervistimi i shtetasve të ndaluar/arrestuar para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e tyre të punës. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me sistemin audio-viziv të kamerave.

Grupi i inspektimit, konstatoi gjithashtu se, në këtë komisarariat nuk kishte asnjë ambient të veçantë hetimi edhe për të miturit, i cili të ishte i monitoruar me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

**Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar.<sup>9</sup>**

Nga monitorimi që iu bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisarariat ishte krijuar një dhomë më vete për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

---

<sup>9</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

## **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Sipas informacionit dhe nga intervistimi i punonjësit të policisë në zyrën e informacionit, rezultoi se zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien çdo personi të shoqëruar, të kopjes së procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi u evidentua se, fashikulli që ndodhej në zyrën e informacionit, përbëhej nga procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”, si dhe procesverbali i shoqërimit, të plotësuar sipas rubrikave, të cilët ishin të firmosur nga punonjësi i policisë që kishte trajtuar çështjen dhe personi i shoqëruar. Gjithashtu, personat e shoqëruar në mjediset e policisë pajiseshin me letrën e të drejtave, që në momentin e hyrjes në ambientet e komisariatit.

Për personat e ndaluar/arrestuar, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b pika 2 dhe 251 të K.Pr.P., ku thuhet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të letrës me të drejtat që gëzojnë këta persona dhe kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Lidhur me të drejtën e ligjshme për informim të personave që ndodhen në dhomat e shoqërimit, si dhe në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë në Mat, gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e tyre ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, u konstatua se punonjësit e zyrës të informacionit dispononin formularë me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja dhe ato ishin pjesë e dokumentacionit që shoqëronin këta persona.

Në takimin që grupi i inspektimit zhvilloi me punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë, rezultoi se, zbatohet detyrimi ligjor për të informuar personat e ndaluar/arrestuar në moshë madhore se, në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës, mund të kërkojë ndihmë juridike dhe ti ofrohet një Avokat mbrojtës kryesisht nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në lidhje me trajtimin e personave në momentin që hyjnë në komisariatet e policisë, sjellim në vëmendje nevojën e verifikimit të gjendjes fizike të personave, për të mënjanuar përgjegjësinë e autoriteteve të policisë, për çështjet e dhunës, sipas rekomandimit edhe të Komitetit Evropian për

Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), i cili në raportin për Shqipërinë të botuar në vitin 2019, midis të tjerave ka cituar se: *“Oficerët e policisë duhet të trajtohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme dhe se ajo mund të përdoret vetëm në rast të kapjes së një personi. Pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme”*<sup>10</sup>. **Mjeku mungonte dhe ky shërbim mbulohej nga ndihmës mjeku i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Burrel.**

**Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut i cili thirrej nga Bashkia e Matit pasi që nuk ishte në organikën e këtij Komisariati.**

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, vizitat mjekësore e të ndaluarve/arrestuarve nga ana e personelit mjekësor ishin kryer brenda afatit 12 orësh nga koha e vendosjes së tyre në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurat standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.<sup>11</sup> Vizitat mjekësore e të ndaluarve/të arrestuarve kryhej nga ndihmës mjeku i IEVP Burrel, pasi Komisariati Policisë Mat nuk ka në organikë personel mjekësor. Shënimet me konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë nga personeli mjekësor hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi gatuhej në kuzhinën e Komisariatit Mat dhe shërbehej nga punonjësit e shërbimit të policisë.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjente, letra higjienike dhe dezinfektant.

---

<sup>10</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-33>

<sup>11</sup> Kreu II, pika 7, procedurave standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:  
b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme **për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë në Komisariatin e Policisë Mat, si dhe ndërtimin e ambienteve të reja** të parashikuara në dokumentin e “Detyrë/Projektimit” sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstrukcionin e ambientit ekzistues të sigurisë, kryesisht në plotësimin e dhomave të sigurisë me krevat për fjetje, eliminimin e lagështirës dhe zgjerimin e dritareve për hyrjen e ajrit dhe ndriçimit të plotë natyral.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mat, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.
4. Marrjen e menjëhershme të masave për plotësimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë pasi mungesa e tyre ndikon ndjeshëm në mbarëvajtjen e punës në këtë institucion.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të kamerave në këtë Komisariat, për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe hyrjet e dhomave të shoqërimit.
6. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomës (zyrës) të intervistimit/marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar të rritur dhe të mitur në këtë komisariat, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.

7. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të ngrohjes në ambientin e sigurisë dhe atë të shoqërimit, për shkak të kushteve të rënda atmosferike të kësaj zone.
8. Marrjen e masave të nevojshme për vënien në funksion të dusheve për larjen e trupit të personave që ndodhen në ambientet e sigurisë.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe të lagështirës në të gjitha ambientet e këtij komisariati.
10. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
11. Vendosijen e kamerave në ambientin e intervistimit në dhomën e shoqërimit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**